

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Ligjet dhe tatimet në Kosovë

P4

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 02.07.2022

Pjesa A. Detyra me zgjidhje të shumëfishtë (vetëm një opsion i saktë) Nga 2 pikë secila

1. Fatura në vlerë prej 12,800.00 Euro para TVSH-së, i dedikohet shitjeve të produkteve farmaceutike, sa duhet të jetë vlera e TVSH-së në këtë faturë?

- a) 2,034.00 Euro;
- b) 1,024.00 Euro;**
- c) 00.00 Euro;
- d) 1,952. 55 Euro.

2. Kompania ENERGO SH.A në muajin Prill 2022 ka pranuar një faturë në vlerë prej 4,200 EUR për shërbime konsulence nga furnitori jashtë vendit. Kompania është e detyruar të përdor ngarkesën e kundër për këtë faturë . Ngarkesa e kundërt do të ketë ndikim në deklaratën e TVSH-së për muajin Prill 2022:

Informatë shtesë – kompania në këtë vit aplikon koeficientin e zbritjeve nga viti i kaluar 70%, pasi që ka shitje me të drejtë zbitje të TVSH-së dhe pa të drejtë zbritje të TVSH-së.

a) 756 .00 Euro rritja e TVSh –së së llogaritur dhe 529.20 Euro rritja e TVSH-së së zbritshme;

b) 756 .00 Euro rritja e TVSh –së së llogaritur dhe 756.00 Euro rritja e TVSH-së së zbritshme ;

c) 529 .20 Euro rritja e TVSh –së së llogaritur dhe 529.20 Euro rritja e TVSH-së së zbritshme ;

d) 0. 00 Euro rritja e TVSh –së së llogaritur dhe 0.00 Euro rritja e TVSH- së së zbritshme;

3. Gazmendi për muajin Prill 2022 ka realizuar të ardhura neto nga punëdhënësi primar në shumë prej 520 EUR. Sa janë obligimet tatimore për këtë muaj që punëdhënësi primar duhet të ndal në burim:
- a) 52.00 Euro;
 - b) 57.77 Euro;
 - c) 33.11 Euro;
 - d) 44.11 Euro.
4. Gazmendi për muajin Prill 2022 ka realizuar të ardhura neto nga punëdhënësi primar në shumë prej 520 EUR. Sa është shuma e kontributit pensional për këtë muaj që punëdhënësi primar duhet paguar si kombinim i pjesës së detyrueshme të pensionit nga i punësuar dhe punëdhënësi:
- a) 52.00 Euro;
 - b) 29.11 Euro;
 - c) 58.22 Euro;
 - d) 26.00 Euro.
5. Furnizimi me energji elektrike i nënshtrohet normës së TVSH-së:
- a) Normës së reduktuar 8%;
 - b) Normës standarde 18%;
 - c) Normës 0;
 - d) Sipas vendimit të ATK-së.
6. Furnizimi me ujë të ambalazhuar i nënshtrohet normës së TVSH-së:
- a) Normës së reduktuar 8%;
 - b) Normës standarde 18%;
 - c) Normës 0;
 - d) Sipas vendimit të ATK-së

7. Sipas Ligjit Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave në fuqi, kontributet e dhëna nga tatimpaguesit në formë të donacionit për qëllime humanitare, shëndetësore, edukativo-arsimore, fetare, shkencore, lejohen si shpenzime deri në maksimumin:
- a) Deri në 5% të qarkullimit bruto;
 - b) Deri në 10% të fitimit neto;
 - c) Deri në 10% të të ardhurave të tatueshme;
 - d) Deri në 20% të tatimit.
8. Kontributet e dhëna nga tatimpaguesit në fushën e sponsorizimeve kulturë dhe rini, llogariten sipas Ligjit Nr. 05/L -090 për Sponsorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe shuma e lejuar është:
- a) Deri në 20% të fitimit;
 - b) Deri në 10% të fitimit;
 - c) Deri në 20% të tatimit ;
 - d) Deri në 30% të tatimit.
9. Sipas ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, shuma e lejuar si zbritje për zhvlerësim në periudhën tatimore për pasuritë e prekshme në grupin e parë sipas metodës lineare në fund të periudhës tatimore është me shkallën:
- a) Pesë përqind (5%);
 - b) Njëzet përqind (20%);
 - c) Dhjetë përqind (10%). ;
 - d) Sipas marrëveshjes në kontratë ose 20 vite.
10. Sipas ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, shuma e lejuar si zbritje për zhvlerësim në periudhën tatimore për pasuritë e prekshme në grupin e dytë sipas metodës lineare në fund të periudhës tatimore është me shkallën:
- a) Pesë përqind (5%);
 - b) Njëzet përqind (20%);
 - c) Dhjetë përqind (10%) ;
 - d) Në varësi të llojit të asetit.

Pjesa B. Pyetjet “E saktë/ E pasaktë”

Nga 1 pikë secila

1. Sipas Ligjit në fuqi “Për Shoqëritë Tregtare”, çdo Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar duhet po ashtu të ketë Memorandumin e inkorporimit.

E saktë

E pasaktë

2. Sipas Ligjit në fuqi “Për Shoqëritë Tregtare”, Shoqëria Aksionare është përgjegjëse për të gjitha borxhet dhe detyrimet e tjera me tërë asetet dhe pasurinë e saj.

E saktë

E pasaktë

3. Organizata joqeveritare nuk mund të jenë aksionare në shoqëri aksionare.

E saktë

E pasaktë

4. Personat fizik nuk mund të jenë aksionarë në shoqëri aksionare.

E saktë

E pasaktë

5. Sipas Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, mikro-ndërmarrjet janë ndërmarrje të cilat nuk tejkalojnë kufijtë e së paku dy(2) nga tre kriteret e përcaktuara nga ky ligj. Njeri nga tre kriteret është qarkullimi neto prej shtatë qind mijë euro (700,000.00 €)

E saktë

E pasaktë

6. Sipas Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, ndërmarrjet e vogla janë ndërmarrje të cilat nuk janë mikro-ndërmarrje, por nuk tejkalojnë më shumë se dy(2) nga tre kriteret e këtij ligji. Njeri nga tre kriteret është pasqyra e pozitës financiare prej tre milion euro (3,000,000.00 €);

E saktë

E pasaktë

7. Sipas Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, ndërmarrjet e mesme janë ndërmarrje të cilat nuk janë as mikro-ndërmarrje e as ndërmarrje të vogla, por nuk tejkalojnë dy (2) nga tre kriteret e këtij ligji. Njeri nga tre kriteret është numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar - njëqind e pesëdhjetë (150).

E saktë

E pasaktë

8. Sipas Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, ndërmarrjet e mëdha janë ato ndërmarrje të cilat në datat e bilancit të tyre të gjendjes tejkalojnë të paktën dy(2) nga tre(3) kriteret e këtij ligji. Njeri nga tre kriteret është numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar dyqind e pesëdhjetë (250)

E saktë

E pasaktë

9. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo person i cili nuk paraqitet në kohën dhe vendin e specifikuar, apo për të dhënë informatat për palët e treta, në përgjigje të kërkesave për informata e ATK-së, do t'i nënshtrohen gjobës pesëqind (500) euro.

E saktë

E pasaktë

10. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Drejtori i Përgjithshëm mund të anulojë dokumentet tatimore të lëshuar nga ATK në qoftë se konstatohet se janë bërë shkelje të legjislacionit tatimor.

E saktë

E pasaktë

11. Shuma e ndonjë tatimi e paguar në përputhje me Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Drejtori i Përgjithshëm do të shpërndahet sipas rendit vijues: 1. shumta e çdo obligimi tatimor; 2 interesi; 3. sanksionet dhe pagesat ndëshkuese dhe 4 shpenzimet e mbledhjes.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas Ligjit në fuqi për Tatimin në të Ardhurat Personale, pensionet e paguara në përputhje me legjislacionin përkatës mbi Pensionet në Kosovë nga Trusti Pensional, janë të ardhura të liruara nga tatimi sipas këtij ligji.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas Ligjit në fuqi për Tatimin në të Ardhurat Personale, nuk lejohet zbritje për ndonjë shpenzim aktual (të ndodhur) apo rrjedhur që lidhet me të ardhurat të cilat i nënshtrohen mbajtjes në burim, pagave, dividendëve, interesit, të drejtave pronësore, qirave, fitoreve në lotari, veç nëse janë paguar më apo para 31 marsit të periudhës tatimore vijuese.

E saktë

E pasaktë

14. Sipas ligjit në fuqi për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, institucionet Financiare të Sigurimeve dhe Risigurimeve, të licencuara nga BQK, në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, kanë të drejtë që t'iu njihen shpenzimet e zbritshme, provizionet për rezervat teknike dhe matematike, deri në tetëdhjetë përqind (80%) të shumës së përcaktuar me Ligjin për Sigurimet dhe aktet nënligjore të nxjerra nga BQK.

E saktë

E pasaktë

15. Sipas ligjit në fuqi për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, interesi, qiraja dhe shpenzimet tjera që i paguhen personave të lidhur nuk lejohen si shpenzime të zbritshme për qëllime tatimore

E saktë

E pasaktë

16. Sipas ligjit të TVSh-së, ofrimi i kujdesit mjekësor në ushtrimin e profesioneve mjekësore dhe para mjekësore siç janë përkufizuar me ligjet në fuqi të Kosovës, janë lirime pa të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme.

E saktë

E pasaktë

17. Sipas Ligjit të TVSH-së, importi i gazit përmes sistemeve të distribuimit të gazit natyror ose importi i energjisë elektrike janë të liruara nga TVSH-ja

E saktë

E pasaktë

18. Sipas Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës, kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues janë personat që kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare.

E saktë

E pasaktë

19. Sipas Ligjit të Punës në Kosovë, kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

E saktë

E pasaktë

20. Sipas Ligjit të Punës në Kosovë, punëdhënësi paraprak nuk është i obliguar që në formë të shkruar t'i informojë të gjithë të punësuarit për bartjen e detyrimeve dhe përgjegjësiive tek punëdhënësi i ardhshëm.

E saktë

E pasaktë

Pjesa C. Pyetjet problemore

Problemi 1

10 pikë

E & F sh.p.k gjatë muajit Prill 2022 regjistroi blerje të produkteve farmaceutike në shumën Euro 22,000 , përfshirë TVSH-në dhe produkte jo farmaceutike në shumën Euro 10,000, përfshirë TVSH-në. Të gjitha këto produkte janë shitur po në këtë muaj. Shitja e produkteve farmaceutike sipas politikës së shitjes së kompanisë është realizuar me marzhën bruto 15%, ndërsa shitja e produkteve jo farmaceutike me marzhën bruto 18%.

Nuk kishte stoqe në fillim të muajit Prill 2022.

Kërkohet:

- Sa ishte vlera e TVSH-së së zbritshme në këtë muaj?
- Sa ishte vlera e TVSH-së së llogaritur në këtë muaj?
- Sa ishte vlera e TVSH-së së pagueshme në këtë muaj?

Zgjidhje

a) Produktet farmaceutike $22,000/13.5 = 1,629.63$ (TVSH me normën 8%)
Produktet jo farmaceutike $10,000/6.55556 = 1,525.42$ (TVSH me normën 18%)
TOTALI i TVSH-së së zbritshme = 3,155.05

b) Produktet farmaceutike $22,000 - 1,629.63 = 20,370.37 + 15\% = 23,425.93$
 $23,425.93 \times 8\% = 1,874.07$ (TVSH e llog. me normën 8%)

Produktet jo farmaceutike $10,000 - 1,525.42 = 8,474.58 + 18\% = 10,000.00$
 $10,000.00 \times 18\% = 1,800$ (TVSH e llog. me normën 18%)

TOTALI i TVSH-së së llogaritur = 1,874.07 + 1,800 = 3,674.07

c) TVSH e pagushme = TVSH e llog. - TVSH e zbrt. = $3,674.07 - 3,155.05$

TVSH e pagushme = 519.02

Ose

Marzha bruto

Produktet farmaceutike	$3,055.56 \times 8\% = 244.45$
Produktet jo farmaceutike	$1,525.42 \times 18\% = 274.57$
TOTAL TVSH e pagushme	519.02

Problemi 2

15 pikë

Kompania ndërtimore Prima Sh.P.K ka filluar projektin me ndërtim të larte që do të zgjat tre (3) vite. Bazuar në përlllogaritjet fillestare kompania planifikon të ardhura në tërësi nga projekti 9,000,000 euro (1,200 për m2) dhe një kosto e tërësishme 7,000,000 euro.

Viti i II- Kompania realizoj inkasimin e keshit nga marrëveshja e re e këtij viti në vlerë prej 1,000,000 Eur. Po ashtu kompania realizoi inkasim të keshit në vlerë prej 800,000 eur nga marrëveshjet e vitit të parë.

Nuk ka shpenzime tjera!

Kërkohet:

Llogaritni obligimin tatimor për këtë vit (Vitin e II) sipas Ligjit Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, gjegjësisht trajtimi i kontratave afatgjata sipas këtij ligji.

Zgjidhje

Të ardhurat për qëllime tatimore	= 1,000,000 + 800,000 =	1,800,000
*KMSH	= 7,000,000 x 0.20 =	(1,400,000)
Fitimi para tatimit		400,000
Tatimi 10%		(40,000)
Fitimi Neto		360,000

*koeficienti nga të ardhurat $1,800,000 / 9,000,000 = 0.20$
Kosto e planifikuar $7,000,000 \times 0.20 = 1,400,000$

Problemi 3**15 pikë**

Kompania B&B sh.p.k me seli në Prishtinë kryen aktivitete ekonomike tregtare dhe prodhuese në tërë territorin e Kosovës. Gjatë muajit Prill 2022 ka pasur këto transaksione:

- i. Shitjet për KFOR në shumë 50,000 Euro;
- ii. Shitjet për tri ambasada të vendosura në Kosovë në shumë 25,000 Euro;
- iii. Shitje e ujit të ambalazhuar për Qeverinë e Kosovës në shumë 40,000 Eur.
- iv. Shitje tjera vendore me normën standarde në shumë 30,000 Eur.
- v. Blerje vendore me normën standarde (lënda e parë) në vlerë 10,000 Euro;
- vi. Shpenzimet tjera për aktivitetet ekonomike me normë standarde 6,000 Euro;
- vii. Shpenzimet tjera për aktivitetet ekonomike me normë të reduktuar 2,000 Euro;
- viii. Notë debiti e pranuar me normë 18% ,vlera 8,000 Euro shuma e tatueshme;
- ix. Notë debiti e lëshuar me normë 18%, vlera 4,000 Euro shuma e tatueshme;
- x. Blerje e shërbimit nga një kompani me seli në Zvicër, vlera 4,000 Euro.

Vlerat e paraqitura janë pa përfshirë TVSH-në.

Kërkesa:

Përpiloni ekstraktin e deklaratës së TVSH-së sipas renditjes, sa ka pagesë/kreditim për muajin 04/2022.

Zgjidhje

Periudha e Deklarimit:	04/2022
Numri fiskal	800111222
Emri i biznesit	B & B
Emri i personit kontaktues	SH.P.K Berati

		Furnizimet		
Shitjet e liruara pa te drejtë kreditimi	[9]			
Shitjet e liruara me drejtë kreditimi	[10]	75,000		
Eksportet	[11]			TVSH e llog
Shitjet e tatueshme me normën 18%	[12]	70,000	[13]	12,600
Shitjet e tatueshme me normën 8%	[14]		[15]	

Nota debitoare e lëshuar,nota kreditore e pranuar me normë 18%	[16]	4,000	[17]	720
Nota debitoare e lëshuar,nota kreditore e pranuar me normë 8%	[18]		[19]	
Fatura e borxhit te keq e pranuar, inkasimi i B.K me normë 18%	[20]		[21]	
Fatura e borxhit te keq e pranuar, inkasimi i B.K me normë 8%	[22]		[23]	
Rregulimet per te rritur TVSH-në me normë 18%	[24]		[25]	
Rregulimet per te rritur TVSH-në me normë 8%	[26]		[27]	
Blerjet që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt	[28]	4,000	[29]	720
			[30]	14,040
		Blerjet		Totali i TVSH së llog
Blerjet dhe importet pa TVSH	[30]			
Blerjet dhe importet investive pa TVSH	[31]			
Blerjet dhe importet meTVSH jo te zbritshme	[33]			*Tvsh e zbrit
Blerjet dhe importet investive meTVSH jo te zbritshme	[34]			
Importet me normë 18%	[35]		[36]	
Importet me normë 8%	[37]		[38]	
Importet investive me normë 18%	[39]		[40]	
Importet investive me normë 8%	[41]		[42]	
Blerjet vendore me normë 18%	[43]	16,000	[44]	2,880
Blerjet vendore me normë 8%	[45]	2,000	[46]	160
Blerjet investive vendore me normë 18%	[47]		[48]	
Blerjet investive vendore me normë 8%	[49]		[50]	
Blerjet nga feremrët vendore me normë 8%	[51]		[52]	
Nota debitoare e pranuar,nota kreditore e lëshuar me normë 18%	[53]	8,000	[54]	1,440
Nota debitoare e pranuar,nota kreditore e lëshuar me normë 8%	[55]		[56]	
Fatura e borxhit te keq e lëshuar, pagesa e borxhit të keq me normë 18%	[57]		[58]	
Fatura e borxhit te keq e lëshuar, pagesa e borxhit të keq me normë 8%	[59]		[60]	
Rregulimet per te ulur TVSH-në me normë 18%	[61]		[62]	
Rregulimet per te ulur TVSH-në me normë 8%	[63]		[64]	
E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt me normë 18%	[65]	4,000	[66]	720
			[67]	5,200
		Kalkulimi		Totali i

Teprica e TVSH-së e bartur nga muaji i kaluar	[68]	
Balanca kreditore e mbetur $69 = ((67+68)-30) > 0$	[69]	
Kërkesa për rimbursim	[70]	
Kreditimi i tvsh-së për muajin pasues $71 = (69-70)$	[71]	
TVSH që duhet të paguhet $72 = (30-67-68) > 0$	[72]	8,840.00

TVSH së
Zbr

Problemi 4

7 pikë

Kompania Tiko Tok sh.p.k. ka pranuar aktin e kontrollit nga ATK për deklaratën e TVSH për muajin 02/2021 me datë 25.04.2022. Obligimi tatimor (pa përfshirë sanksionet) i dalë nga akti i kontrollit për këtë muaj është në vlerë prej 9,200 Eur.

Kompania, për këtë periudhë kishte deklaruar dhe paguar me datë 18/03/2021 në shumë 32,000 Eur.

Sa janë gjobat dhe interesi për tatimin shtesë nga ky akt i kontrollit bazuar në përlllogaritjen që parasheh Ligji mbi Procedurat dhe Administratën Tatimore?

Zgjidhje

1.Gjoba për nën deklaram tatimor 25%	$9,200 * 25\% = 2.300$
2. Gjoba për mos pagesë në kohë 1% muaj (12muaj max)	$9,200 * 12\% = 1,104$
<u>3..Interesi 0.65% ne muaj (14 muaj)</u>	<u>$s 9,200 * 9.10\% =$</u>
<u>837.20</u>	
TOTALI i sanksioneve	4241.20

Problemi 5

5 pikë

Kompania ANA Sh.p.k gjatë fillimit të vitit 2021 bleu një gërmues dheu në shumë prej 82,000 EUR dhe pesë (5) kompjuterë në shumë prej 800 eur për secilin.

Kërkohet:

1. Të llogariten të gjitha shpenzimet e pranuar për këtë vit sipas Ligjit Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave për këto asete.

Zgjidhje

a) Gërmuesi i dheut:

$$\text{Zhvlerësimi } 82,000 \times 20\% = 16,400$$

$$\underline{\text{Lejimi i posaçëm } 82,000 \times 10\% = 8,200}$$

$$\text{Shpenzimet} \quad 24,600$$

b) Kompjuterët $800 \times 5 = 4,000$ shpenzimet

$$\text{Total Shpenzimet} = a+b=24,600+4000 = 28,600$$

Problemi 6**8 pikë**

Kompaninë Buro SH.P.K muajin Prill 2022 kishte këtë listë të pagave:

Drejtori: 1,500 Eur – Paga Neto

Menaxheri: 950 Eur - Paga Neto

Udhëheqësi: 700 Eur – Paga Neto

Zyrtari 1: 500 Eur – Paga Neto

Zyrtari 2: 400 Eur – Paga Neto

Kërkohet:

1.Llogaritni detyrimin e tatimit në paga që është mbajtur në burim nga punëdhënësi për muajin Prill 2022 si dhe kontributin pensional.

Zgjidhja

		Paga Bruto	KP i pun	Kp.Biz.	Paga e tatush	TAP	Paga Neto
1*	Drejtori	1728.42	86.42	86.42	1,642.00	142.00	1,500.00
2*	Menaxheri	1085.15	54.26	54.26	1,030.89	80.89	950.00
3*	Udhëheqësi	792.75	39.64	39.64	753.11	53.11	700.00
4*	Zyrtar 1	558.83	27.94	27.94	530.89	30.89	500.00
5*	Zyrtari 2	442.56	22.13	22.13	420.43	20.43	400.00

TOTAL		4,607.71	230.39	230.39	4,377.32	327.32	4,050.00
--------------	--	-----------------	---------------	---------------	-----------------	---------------	-----------------

1*	Drejtori - 1, 500 Neto						
	a	b	c=a*b	d=a-c	f=d/95%	h=a*5%	j=a*5%
	Paga e	Shkalla	Tatimi	Paga	Paga bruto	KP i	KP i
	tatueshme	tatimore		Neto		punësuarit	punëdhënësit
	80	0	0	80	84.21	4.21	4.21
	170	4%	6.8	163.2	178.95	8.95	8.95
	200	8%	16	184	210.53	10.53	10.53
	1192	10%	119.2	1072.8	1,254.74	62.74	62.74
TOTAL	1642	0.22	142.00	1,500.00	1,728.42	86.42	86.42

2*	Menaxheri - 950 Neto						
	a	b	c=a*b	d=a-c	f=a/95%	h=a*5%	j=a*5%
	Paga e	Shkalla	Tatimi	Paga	Paga bruto	KP i	KP i
	tatueshme	tatimore		Neto		punësuarit	punëdhënësit
	80	0	0	80	84.21	4.21	4.21
	170	4%	6.8	163.2	178.95	8.95	8.95
	200	8%	16	184	210.53	10.53	10.53
	580.89	10%	58.09	522.8	611.46	30.57	30.57
TOTAL	1,030.89	0.22	80.89	950.00	1,085.15	54.26	54.26

3*	Udhëheqësi- 700 Neto						
	a	b	c=a*b	d=a-c	f=d/95%	h=a*5%	j=a*5%
	Paga e	Shkalla	Tatimi	Paga	Paga bruto	KP i	KP i
	tatueshme	tatimore		Neto		punësuarit	punëdhënësit
	80	0	0	80	84.21	4.21	4.21
	170	4%	6.8	163.2	178.95	8.95	8.95
	200	8%	16	184	210.53	10.53	10.53

	303.11		10%	30.31	272.8	319.06	15.95	15.95
TOTAL	753.11	0.22		53.11	700.00	792.75	39.64	39.64
4*	Zyrtari 1- 500	Neto			-			
	a	b	c=a*b	d=a-c	f=d/95%	h=a*5%	j=a*5%	
	Paga e	Shkalla	Tatimi	Paga	Paga bruto	KP i	KP i	
	tatueshme	tatimore		Neto		punësuarit	punëdhënësit	
	80	0	0	80	84.21	4.21	4.21	
	170	4%	6.8	163.2	178.95	8.95	8.95	
	200	8%	16	184	210.53	10.53	10.53	
	81	10%	8.09	72.8	85.15	4.26	4.26	
TOTAL	530.89	0.22		30.89	500.00	538.83	27.94	27.94
5*	Zyrtari 2- 400	Neto			-			
	a	b	c=a*b	d=a-c	f=d/95%	h=a*5%	j=a*5%	
	Paga e	Shkalla	Tatimi	Paga	Paga bruto	KP i	KP i	
	tatueshme	tatimore		Neto		punësuarit	punëdhënësit	
	80	0	0	80	84.21	4.21	4.21	
	170	4%	6.8	163.2	178.95	8.95	8.95	
	170.43	8%	13.63	156.8	179.41	8.97	8.97	
	0	10%	0		-	-	-	
TOTAL	420.4347826	0.22		20.43	400.00	442.56	22.13	22.13